



KOMUNA E GLLOGOCIT NË PARTNERITET ME PROGRAMIN ReLOaD3

SHPALL:

THIRRJEN E PARË PUBLIKE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE PËR DORËZIMIN E PROJEKT PROPOZIMEVE NË PROGRAMIN RAJONAL PËR DEMOKRACINË LOKALE NË BALLKANIN PERËNDIMOR 3

(ReLOaD3)

Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 3 (ReLOaD3¹) bazohet në dy fazat e mëparshme të iniciativës rajonale – ReLOaD1 dhe ReLOaD2, të cilat u zbatuan ndërmjet viteve 2017-2024 në Shqipëri, Bosnjë e Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Serbi. Gjatë këtij periudhe 8-vjeçare, dy faza të programit ReLOaD u zbatuan në 11 komuna në Kosovë. Komunitet që morën pjesë në ReLOaD1 dhe ReLOaD2 janë: Dragash, Istog, Kamenicë, Lipjan, Mitrovicë, Podujevë, Rahovec, Skenderaj, Shtërpçë, Viti dhe Zveçan. Programi ka mbështetur gjithashtu 80 Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC) për të zbatuar projekte në njërin nga këto komuna partnere. ReLOaD3 do të vazhdojë të forcojë qeverisjen lokale dhe angazhimin e shoqërisë civile në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Duke promovuar bashkëpunimin rajonal, projekti synon të rrisë kapacitetet e qeverive lokale dhe OSHC-ve për të krijuar partneritete efektive, për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve dhe për t'u harmonizuar me strategjitë dhe prioritetet lokale të zhvillimit.

Programi gjithashtu do të përmirësojë dialogun midis Qeverive Lokale dhe OSHC-ve, do të nxisë bashkëpunimin e tyre duke përhapur dhe konsoliduar praktikën pozitive të financimit të OSHC-ve në të gjitha nivelet institucionale dhe do të investojë në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve të OSHC-ve për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre. Për më tepër, ReLOaD3 do të fokusohet në mundësimin që një numër i konsiderueshëm i qeverive lokale të adoptojnë dhe mbajnë standarde të larta të transparencës dhe llogaridhënies në operacionet e tyre, duke zgjeruar një model të suksesshëm të financimit transparent të projekteve të OSHC-ve (metodologjia LOD²) nga buxhetet e qeverive lokale, drejt një angazhimi më të madh publik në procesin vendimmarrës dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve lokale. Kjo qasje gjithashtu do të forcojë dialogun me fokus në rezultate midis OSHC-ve, banorëve dhe autoriteteve lokale, duke kontribuar në një qeverisje lokale më gjithëpërfshirëse, përmirësimin e shërbimeve komunale dhe zhvillimin e qëndrueshëm në përgjithësi.

Buxheti total i programit është 13.4 milion USD, me 1.4 milion USD të dedikuara për komponentin e Kosovës, financuar nga BE-ja (nga Instrumenti për Ndihmën para-Anëtarësimit III – IPA III) dhe bashkëfinancuar nga UNDP dhe Qeveritë Lokale. Në

¹ Referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

² Për Bashkimin Evropian, ky përcaktim është pa paragjykuar pozicionet rreth statusit, si dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të KS të OKB-së dhe opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

³ https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/ba/LOD_Metodologjia_09_02_2015.pdf.

Kosovë, katër komuna të reja dhe një komunë partnere nga faza e parë e ReLOaD janë përfshirë në ReLOaD3 bazuar në një proces konkurrues aplikimi dhe përzgjedhjeje (Glllogoc, Gjakovë, Istog, Malishevë dhe Vushtrri).

Objektivi i përgjithshëm i thirrjes publike për projekt-propozimet e OSHC-ve dhe prioritetet e thirrjes publike

Komuna e Glllogocit dhe UNDP-ja shpallin thirrje publike për OSHC-të, me qëllim të forcimit të mëtijshëm të partneriteteve ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe autoriteteve lokale, si dhe përmirësimit të ofritit të shërbimeve lokale.

Fushat e përgjithshme tematike që janë në fokus të programit ReLOaD3 janë: qytetet dhe komunitetet e qëndrueshme, trashëgimia kulturore, fuqizimi ekonomik, shërbimet sociale për grupet më të cenueshme, përfshirja sociale, barazia gjinore, mbrojtja e mjedisit, të drejtat e njeriut, etj.

Në këtë thirrje, OSHC-të nga Kosova mund të dorëzojnë projekt propozime, megjithatë prioritet do t'u jepet OSHC-ve që veprojnë në Komunën e Glllogocit.

Fushat prioritare në komunën e Glllogocit që janë përcaktuar bashkërisht për këtë thirrje publike janë:

Fushat prioritare:

1. Fuqizimi i ekonomisë lokale përmes shfrytëzimit të potencialit turistik dhe kulturor

- 1.1. Zhvillimi i zonave rurale dhe mbështetja e bizneseve/prodhuesve lokal;
- 1.2. Fuqizimi dhe promovimi i trashëgimisë dhe diversitetit kulturor, zejeve, festivaleve, veshjeve dhe traditave lokale në shërbim të turizmit;
- 1.3. Promovimi i përfshirjes së komunitetit në aktivitete kulturore dhe artistike përmes panairave dhe aktiviteteve artistike tjera.
- 1.4. Nxitja e aktiviteteve mbështetëse për të rinjtë në zhvillimin e shkathtësive të buta dhe profesionale.

2. Promovimi dhe përkrahja e komunitetit në proceset e vendimmarrjes dhe mbështetja e mirëqenies sociale dhe gjithëpërfshirjes

- 2.1. Nxitja e pjesëmarrjes aktive së të rinjve, grave dhe komunitetit në proceset vendimmarrëse dhe bashkëpunimin me autoritetet lokale;
- 2.2. Mbështetja e programeve të trajnimit, mentorimit dhe fushatave që fuqizojnë zërin e të rinjve, grave dhe komunitetit;
- 2.3. Promovimi i barazisë gjinore, përfshirjes sociale dhe respektimit të diversitetit shoqëror e kulturor.
- 2.4. Nxitja e aktiviteteve integruese dhe mbështetëse për grupmoshat e ndryshme në jetën aktive dhe publike.

3. Promovimi dhe zhvillimi i sportit dhe aktiviteteve rekreative

- 3.1. Promovimi i aktiviteteve sportive për fëmijë, të rinj, gra grupet e marginalizuara dhe komunitetin e gjerë, me fokus në stilin e jetesës së shëndetshme si dhe nxitjen e sportit amator, rekreativ dhe gjithëpërfshirës;

4. Mbrojtja e ambientit dhe promovimi i mjedisit të pastër dhe të qëndrueshëm

4.1. Ndërgjegjësimi dhe gjithëpërfshirja e komunitetit në pastrimin dhe ruajtjen e hapësirave publike, pasurive natyrore dhe menaxhimin e mbeturinave;

4.2. Promovimi i iniciativave të gjelbra, vullnetarizmit mjedisor dhe qytetarisë aktive.

Idetë e projektit të ofruara nën prioritetet kryesore janë një mostër e projekteve të mundshme, por jo të kufizuara për idetë e tjera të projektit që lidhen me fushat kryesore prioritare (teksti në 'Bold').

Fonde do t'u ndahen atyre OSHC-ve, projektet e të cilave i kontribuojnë zgjidhjes së një apo më shumë prioritetëve, plotësimi të kriterëve dhe kushteve të tjera të thirrjes publike.

Fondet (grantet) në dispozicion për projekte

Vlera totale e ndarë për këtë thirrje publike është rreth **52,000,00 EUR³** (nga të cilat 30% është financuar nga komuna e Glllogocit).

Vlera e granteve: 5,000 EUR deri në 30,000.00 EUR;

Kohëzgjatja e projekteve të ndara mund të jetë prej 6 deri në 12 muaj, duke filluar nga maji 2026 deri në prill 2027.

Aplikanti mund të dorëzojë maksimumi një projekt propozim në kuadër të kësaj thirrjeje komunale.

Aplikanti mund të dorëzojë maksimumi një projekt propozim në kuadër të kësaj thirrjeje, i cili përmban të gjitha dokumentet e kërkuara. I njëjti aplikant mund të aplikojë për maksimum 2 thirrje komunale në kuadër të ReLOaD3.

Komuna dhe UNDP e rezervojnë të drejtën për të mos i dhënë të gjitha fondet në dispozicion nëse projekt-propozimet e dorëzuara nga OSHC-të nuk i plotësojnë kriteret.

PËRSHTATSHMËRIA/PRANUESHMËRIA:

Pjesëmarrja në këtë thirrje publike është e hapur, në baza të barabarta, për të gjitha OSHC-të e regjistruara zyrtarisht (shoqata/organizata apo fondacion) në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Kosovë. Të gjitha organizatat e shoqërisë civile të interesuara mund të gjejnë informacion të hollësishëm rreth kushteve për aplikim si dhe për kriteret për financimin e projekteve në Udhëzimin për Aplikantë, pjesë përbërëse e dokumentacionit të thirrjes publike.

DOKUMENTACIONI:

Ku dhe si të merret e dorëzohet dokumentacioni për aplikim

Të gjitha informatat dhe verzioni elektronik i të gjithë pakos së dokumenteve për aplikim mund të gjenden në adresën zyrtare të komunës së Glllogocit <https://glllogoc.rks-gov.net/> dhe në web faqen e UNDP-së www.ks.undp.org.

- Paketa e aplikimit do të vendoset gjithashtu në folderin e përbashkët të caktuar për OSHC-në aplikuese. Çdo OSHC e interesuar ose përfaqësues i autorizuar mund të kontaktojë ekipin e projektit ReLOaD3 përmes e-mailit: reload.ks@undp.org për të marrë qasje në folderin e përbashkët për organizatën e shoqërisë civile përkatëse.

Email-i duhet të ketë subjektin: **ReLOaD3 – Thirrja Publike për OSHC-të Glllogoc – Qasje në Aplikim.**

³ Kjo shumë mund të jetë subjekt i ndryshimeve në USD/EUR sipas kursit të këmbimit të OKB-së.

Gjatë ngarkimit të aplikimit të plotë, OSHC-të aplikuese këshillohen të verifikojnë nëse dokumentacioni/paketa e aplikimit të kërkuar është e plotësuar. Kjo bëhet duke plotësuar **Listën e Kontrollit (Shtojca 7)**, e cila është pjesë përbërëse e aplikimit.

Thirrja për aplikim është e hapur nga 09 shkurt 2026 ndërsa afati i fundit për aplikim është më 23 mars 2026 deri në ora: 16:00.

Informacione shtesë

Pas sesionit informues të mbajtur me datë 09 shkurt 2026 pason trajnimi dy ditor se si shkruhet projekt propozimi (Cikli i Menaxhimit të Projektit/CMP), më 10 dhe 11 shkurt 2026 në Sallën e Asamblesë Komunale, duke filluar nga ora 10:00.

Qëllimi i trajnimit është të forcojë kapacitetet e organizatave për të hartuar dhe zbatuar projekte që kontribuojnë në zhvillimin lokal dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe të aplikojnë aftësitë e nevojshme për zhvillimin e ideve të projektit, shkrimin efektiv të projektit, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të projektit përmes punës praktike.

Gjatë tërë kohëzgjatjes së **thirrjes publike do të ofrohet mbështetje nga ekspertët/mentorët me datat 16 dhe 17 mars 2026 në sallën e Asamblesë Komunale**. Ndihma do të jetë e hapur dhe publike, ndërsa orari, duke përfshirë datën dhe orën, do të ndahet nëpërmjet faqes së internetit të komunës së Glllogocit. Për qëllime të transparencës, procesverbali i takimeve me mentorin do të publikohet në ueb faqen e Komunës së Glllogocit. Kjo do ta bëjë të disponueshme informacionin për OSHC-të që nuk kanë mundur të marrin pjesë në takimet me mentorin.

Përveç kësaj, të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me thirrjen publike mund të dorëzohen përmes postës elektronike në adresën e mëposhtme: registry.ks@undp.org duke iu referuar thirrjes publike. Pyetjet mund të dorëzohen deri më 16 mars 2026, ndërsa përgjigjet do të jepen me shkrim brenda tri (3) ditëve të punës pas datës së pranimit. Për qëllime të transparencës, të gjitha përgjigjet do të publikohen në faqen e internetit të UNDP-së (www.ks.undp.org).

Gjithashtu, dokumenti “Pyetjet më të shpeshta” do të publikohet në faqen e Komunës dhe UNDP-së gjatë thirrjes publike, së bashku me dokumentet e tjera të Thirrjes Publike. Dokumenti synon të ofrojë ndihmë shtesë për aplikantët në mënyrë që të kenë një pasqyrë të pyetjeve të bëra më parë që aplikantët kishin gjatë thirrjeve të mëparshme.

Te bashkangjitur keni formularët (Shtojcat) që duhet plotësuar :

- [Shtojca 1 Formulari-i-Aplikimit-per-Projekt-Propozimin Glllogoc](#)
- [Shtojca 2 Ndarja e Buxhetit Glllogoc](#)
- [Shtojca 3 Korniza Logjike Glllogoc](#)
- [Shtojca 4 Plani i Aktiviteteve & Vizibilitetit Glllogoc](#)
- [Shtojca 5 Shtojca 5 – Identifikim Admin-Financiar-persht Glllogoc](#)
- [Shtojca 6 Formulari i Deklaratës se Partneritetit Glllogoc](#)
- [Shtojca 7 Lista e Kontrollit Glllogoc](#)
- [Shtojca 8 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm VETEM PER LEXIM](#)
- [Udhëzimet për aplikantet Glllogoc](#)